



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



RAPORT VJETOR PËR VITIN 2020

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES DHE
SHPËTIMIT



Drejtoria:*Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit***Periudha raportuese:***Janar – dhjetor 2020***Përmbledhje e drejtorisë – ndarja në sektorë, numri i punonjësve dhe funksionet kryesore:**Sektorë në kuadër të drejtorisë:

1. Sektori për shërbime publike;
2. Sektori për menaxhimin e mbeturinave dhe mjedisit;
3. Sektori për mbrojtje dhe shpëtim;
4. Sektori për transport dhe trafik.

Punonjësit në kuadër të sektorëve:

1. Sektori për shërbime publike ka 8 punonjës;
2. Sektori për menaxhimin e mbeturinave dhe mjedisit ka 4 punonjës;
3. Sektori për mbrojtje dhe shpëtim ka 10 punonjës;
4. Sektori për transport dhe trafik ka 3 punonjës;

Funksionet kryesore të drejtorisë sipas sektoreveFunksionet e sektorit për shërbime publike:

- Jep pëlqim për shfrytëzimin e hapësirave publike në përputhje me planet dhe rregulloret komunale;
- Në bazë të ligjit dhe udhëzimeve administrative, bënë trajtimin e qenve endacakë.
- Organizon sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike përmes inventarizimit;
- Në bashkëpunim me banorët, bën rregullimin dhe riparimin e ashensorëve në banesat kolektive;
- Organizon dhe mbikëqyrë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të shesheve, rrugëve dhe trotuareve në zonën urbane dhe rurale të komunës;
- Bën planifikimin dhe menaxhimin e mirëmbajtjes, rikonstruktimit, zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit të ndriçimit publik;
- Është përgjegjëse për ndriçimin publik;
- Bën rregullimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve, fontanave dhe krojeve publike;

Funksionet e sektorit për menaxhimin e mbeturinave dhe mjedisit:

- Mbikëqyrë mbledhjen, transportimin deri në deponi të mbeturinave nga amvisëritë, institucionet dhe lokalet afariste, mbeturinave të vëllimshme, mbeturinave ndërtimore, mbeturinave të biodegradueshme dhe kompostimin e tyre, si dhe llojeve tjera të mbeturinave të cilat janë në kompetencë të nivelit lokal;
- Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aspekteve ekonomike dhe te aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
- Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit të mjedisit përmes eliminimit të deponive ilegale dhe aktiviteteve tjera relevante;
- Përcakton lokacionin e kontejnerëve;
- Informon publikun për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Në përputhje me ligjet dhe aktet komunale, përgatit programin për uljen e nivelit të ndotjes së mjedisit dhe propozon projekte për mbrojtjen e mjedisit, në bashkëpunim me institucione qendrore e lokale dhe donatorë;
- Përkujdeset për ruajtjen e ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore nga ndotësit;

- Mbikëqyrë administrimin e vlerave natyrore, si: ajri, uji, toka, pyjet, lëndët minerale dhe të mirat natyrore publike;

Funksionet e sektorit për mbrojtje dhe shpëtim:

- Vlerëson rrezikshmërinë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera brenda territorit të komunës, si dhe harton planet për mbrojtje;
- Kujdeset për funksionimin dhe aktivizimin e Sistemit të Alarmit Publik në rast të rrezikut;
- Është përgjegjës për organizimin e qytetarëve në forcat për mbrojtje dhe shpëtim, në rast nevoje si dhe propozimin për themelimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Në përputhje me ligjet dhe në rast nevoje është përgjegjëse për koordinimin e punëve me institucionet qendrore dhe komunat tjera në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit.
- Në rastet e jashtëzakonshme, i propozon Kryetarit të Komunës shpalljen e gjendjes Emergjente, si dhe masave që duhet të ndërmerren për përballimin e situatës;
- Kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e strehimoreve publike;
- Bën pranimin e informatave nga qytetarët, subjektet Komunale dhe i dërgon për personin apo subjektin që i dedikohen (Qendra e thirrjeve);
- Në përputhje me ligjet dhe aktet komunale, harton Planin për Mbrojtje nga Zjarri, Planin Operativ Emergjent dhe Planin nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;
- Ndërmerr masa për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Në raste emergjente nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera bën evakuimin dhe strehimin e përkohshëm të qytetarëve:
- Bashkëpunon me BPZ-në gjatë intervenimeve emergjente dhe intervenimeve nga zjarri;
- Kujdeset për furnizim me ujë të pishëm me cisterna dhe rezervuarë të veçant, në rast nevoje;
- Ndërmerr masa preventive për parandalimin e vërshimeve përmes pastrimit të Shtratit të lumenjeve, kanalizimit atmosferike, pastrimi i proskave, kanaleve të hapura dhe portave hyrëse;
- Bën monitorimin dhe vëzhgimin e kamerave të sigurisë në Qendren e thirrjeve;
- Ndërmerr masa gjatë rasteve emergjente:
- Bënë regjistrimin e objekteve të vjetra dhe objekteve tjera me rrezikshmëri të lartë, zonave me rrezikshmëri të lartë nga shembjet e dheut dhe vërshimet;

Funksionet e sektorit për transport dhe trafik:

- Koordinon aktivitetin dhe jep pëlqimin për veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, me kompanitë publike dhe private;
- Cakton linjat dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve, sinjalizimin e vend ndaljeve për autobusë, pritoreve të udhëtarëve;
- Cakton lokacionet për parkimin e veturave auto-taksi;
- Menaxhon sektorin me “Merimangë”, sipas rregullores, dhe përgatit procedurat për ankand publik për automjetet e konfiskuara, që kalojnë afatin e paraparë me ligj;
- Bashkëpunon me policinë për rregullimin e komunikacionit dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion, në veçanti afër shkollave dhe institucioneve parashkollore;
- Kujdeset për sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve ekzistuese dhe rregullon komunikacionin në qytetin e Prishtinës;
- Ndërtimi i nyjave të reja të semaforëve në udhëkryqet e qytetit dhe mirëmbajtja e semaforëve ekzistues;
- Vendos për mbylljen e përkohshme të rrugëve, për shfrytëzimin e tyre në raste të veçanta (festa shtetërore, punë të veçanta në interes të shtetit dhe komunës dhe punë të ngjashme);

- Eshhtë kompetente për dhënjën e lejeve qe i përkasin Komunës, për vendosjen e sinjalizimit;
- Mbikëqyrë kushtet e sigurisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve në vendndërtim dhe rreth tij, gjatë zhvillimit të punimeve.

Realizimi i buxhetit të menaxhuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit **78.86%**.

Nr.	Mjetet	Totali
1	Buxheti për vitin 2020	10,472,622.82 €
2	Bartja nga viti 2019-2020	2,046,144.64 €
3	Realizimi për vitin 2020	9,562,189.88 €
4	Kontrata të proceduara për shkëputje	717,978.22€
5	Në realizim	1,323,599.36 €
6	Të proceduara në prokurim	915,000.00€
7	Të proceduara për pagesë në vitin 2020 por të paguara në vitin 2021	310,595.18€
Realizimi i buxhetit		78.86%

Projektet të cilat janë të proceduara në prokurim nga buxheti i vitit 2020 të menaxhuara nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Nr.	Projektet e proceduara në prokurim	Vlera e deklaratës së disponshmërisë
1	Mirëmbajtja e ndriçimit publik në 6 lloto	150,000.00 €
2	Fushata vetëdijesues	25,000.00 €
3	Inventarizimi i hapësirave publike	280,000.00 €
4	Zgjerimi dhe modernizimi i ndriçimit publik	260,000.00€
5	Konsulencë për identifikimin e nevojave për komunikacion dhe trafik rrugorë dhe trajtimin e hapësirave publike	200,000.00 €
Totali:		915,000.00 €

Projektet të cilat janë dërguar për proceduara për shkëputje nga buxheti i vitit 2020

Nr.	Kontratat të proceduara për shkëputje	Totali
1	Intervenimi dhe mirëmbajtja në pompa, kanalizimi atmosferik, fontanna, kroje publike, monumente dhe mure rezistuese -Lloto III	68,220.00 €
2	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve	559,469.22 €
3	Rregullimi i rrethojave të varrezave	90,289.00 €
Totali:		717,978.22 €

Menaxhimi i shërbimeve publike gjatë pandemisë Covid 19

Stafi i DSHPMSH-së vazhdimisht ballafaqohet me sfida dhe nevojë për intervenime të menjëherëshme. Këtë vit pandemie sfidat kanë qenë të shumëfishuara. Përkundër gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar, shërbimet publike janë ofruar në mënyrë të rregulltë përgjatë 2020. Vlenë të ceket se në pjesën më të madhe këtë vit kemi punuar me staf të reduktuar fillimisht disa muaj për shkak vendimit të qeverisë që të punohet vetëm me staf esencial e pastaj edhe si pasojë e infektiveve brenda stafit ose të familjarëve të tyre, ku deri tani kanë qenë të infektuar/izoluar 20 zyrtarë nga 25 sa ka DSHPMSH. Megjithatë, duke marr parasysh përgjegjësinë që mban kjo drejtori dhe nevojat e qytetarëve gjatë kësaj periudhe, shërbimet publike janë ofruar rregullisht duke organizuar edhe aktivitete të ndryshme shtesë për të reduktuar mundësitë e përhapjes së virusit. Aktivitetet shtesë janë përcaktuar duke u bazuar edhe në praktikat e vendeve udhëheqëse në menaxhimin e pandemisë, aktivitete që kanë përfshirë:

- Larjen e thellë e rrugëve;
- Dezinfektimin e mobilerisë urbane;
- Shpeshtimin e fshirjes dhe larjes së rrugëve dhe trotuareve;
- Sigurimin e tualeteve publike për Policinë e Kosovës në të gjitha pikat hyrëse të Prishtinës;
- Vendosjen e shenjave ndaluese në parqe dhe sheshe.



Rregullimi i nënkalimeve

Gjatë vitit 2020 ka filluar riparimi i hapësirave brenda 4 nënkalimeve:

- Kalabri – QKUK;
- Kalabri – Dardani;
- Xhamia e Llapit – Shkolla Model;
- Bardhosh.

Riparimi i hapësirave brenda këtyre nënkalimeve ka paraqitur nevojën për pastrim, demolim, fasadim, ngjyrosje, nivelizimim, vendosje të pllakave, rregullim të ndriçimit, rregullim të ujëmbledhësve dhe vendosje të mbajtësve përgjatë pjerrinës.

Qëllimi i këtij projekti ka qenë që të promovohet siguria e kalimtarëve gjatë qarkullimit në këto hapësira dhe njëherazi Prishtinës t'i jepet sa më shumë ngjyrë dhe gjallëri. Përpos aspektit të sigurisë dhe anës artistike, gërshetimi ngjyrave të ndezura në nënkalime është bërë me qëllimin që ato të japin efekte psikologjike të qytetarët duke marrë parasysh faktin se truri i njeriut i percepton ngjyrat para formave.

Arti brenda nënkalimit që përfshin tri ngjyra parësore nga paleta e ngjyrave e bënë që kalimi përgjatë kësaj hapësire të përjetohej si siguri, ngrohtësi dhe qetësi në ecje. Nënkalimet të cilat nuk kanë ndonjë shfrytëzim komercial mund të jenë monotone dhe të papëlqyeshme në ecje andaj e kemi shfrytëzuar një simetri brenda tyre në mënyrë që ndjesia e kalimit në to të përjetohej si më e shpejtë. Vijat e ndriçimit të vendosura në tavanet e nënkalimeve kanë ndjekur vijat ndarëse mes ngjyrave në formë paralele, gjë që shton dëshirën të ecësh nëpër hapësirë.

Ndërsa, në hyrje-daljet e nënkalimeve është aplikuar ngjyra e verdhë e cila tërheq vëmendjen në qarkullimin rrugor dhe rrit përqendrimin në këndvështrimin pamor.

Akoma pa u realizuar tërësisht punët në ta, këto nënkalime filluan të bëhen edhe pikë identifikuese e qytetit. Kanë filluar të xhirohen reklama në ta, disa artistë kanë realizuar edhe videoklipe aty, qytetarë të shumtë po e shohin si hapësirë atraktive për të bërë fotografi, madje edhe media të njohura ndërkombëtare kanë paraqitur pamje nga këta nënkalime (p.sh. mediumi i njohur britanik *The Telegraph*). Dy nënkalimet e para (Kalabri – QKUK dhe Kalabri – Dardani) kanë përfunduar, kurse të tjerët do përfundojnë brenda një periudhe të shkurtër.





NEWS WEBSITE OF THE YEAR
The Telegraph Log in ☰


Coronavirus News Politics Sport Business M

See all News

🏠 News
12 Dec 2020
Pictures of the Day: 12th December 2020

[f share](#) [🐦](#) [📧](#) [✉](#)

< > 17 of 20 [View All](#)



Pedestrians walk through a underpass painted by local artist Zejnije Kastrati, in Pristina, Kosovo






Largimi i deponive ilegale në territorin e Komunës së Prishtinës

Përveç sistemit të rregulltë të menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Prishtinës ballafaqohet me problemin e krijimit të deponive ilegale. Në vitin 2019 janë identifikuar 145 deponi ilegale, kurse përgjatë 3 çerekut të parë të 2020 i kemi larguar 125 prej tyre. Ky largim i deponive ka vazhduar edhe në muajt e fundit të 2020 duke eliminuar dhe dy deponi të mëdha dhe një deponi të mesme. Kështu, deri në fund të vitit 2020 kemi **zvogëluar numrin e deponive ilegale** brenda territorit të komunës sonë **nga 145 në 17**.

Gjithsejt janë larguar 101,727.00 m³ mbeturina nga demolimi.



Në anën tjetër, largimi i deponive të vogla ilegale realizohet në baza ditore përmes shërbimit të grumbullimit të mbeturinave. Për më tepër, me qëllim të parandalimit të rikrijimit të deponive të tilla, aty ku është e mundur, kemi filluar edhe rrethimin e lokacioneve me dhe apo rrethoja. Rrethimin me dhe e kemi bërë te disa lokacione ku kemi pasur deponi të mëdha ilegale, kurse rrethimi me rrethoja është një projekt i cili ka filluar realizimin në përfundim të vitit 2020 dhe vazhdon edhe në 2021.



Vendosja e pengesave në rrethrotullime

Për ngritjen e nivelit të sigurisë në rrethrotullime si dhe për ngritjen e nivelit të shërbimit në to, gjatë vitit 2020 janë vendosur pengesat shiritore, ishujt dhe është bërë sinjalizimi vertikal i nevojshëm. Gjithashtu, është realizuar edhe ngjyrosja e skajorëve në rrethrotullimet në të cilat është intervenuar.

Fillimisht, ky intervenim është realizuar në 3 rrethrotullime shumë të rëndësishme të qytetit:

- Rrethrotullimi që lidhë rrugët “B” dhe “Muharrem Fejza”;
- Rrethrotullimi në përfundim të rrugës “Agim Ramadani” (në afërsi të objektit të vjetër të Komunës).;
- Rrethrotullimi në rrugën “Ahmet Krasniqi” (në afërsi të objektit të ri të Komunës).



Pas funksionimit të suksesshëm të këtyre ndarjeve të shiritave në rrethrotullimet e lartcekura dhe pas mikpritjes nga qytetarët, është vazhduar intervenimi edhe në lokacionet tjerë. Në fund të 2020 në këtë formë është rregulluar rrethrotullimi që lidhë rrugën “Tirana” me “Ahmet Krasniqin” (Arbëri) dhe brenda një kohe të shkurtër do fillohet me atë që lidhë rrugët “B” dhe “C” dhe me tjetrin afër “KRU Prishtina”.



Ky projekt është në zbatim e sipër dhe parashihet që intervenime të ngjashme – ndarje fizike dhe lyerje të skajorëve si formë sinjalizimi – të kemi edhe në rrethrotullimet dhe udhëkryqet tjera sipas nevojës për rregullimin e qarkullimit të automjeteve dhe zvoglimin e pikave të kontaktit dhe, rrjedhimisht, rrezikut në trafik.



Mirëmbajtja e verore e rrugëve dhe trotuareve

Përmes mirëmbajtjes verore organizohet fshirja dhe larja e rrugëve dhe trotuareve të zonës urbane. Ky shërbim bëhet duke ndarë zonën urbane në 6 lloje. Mirëmbajtja verore është organizuar duke kategorizuar rrugët sipas numrit të automjeteve dhe këmbësorëve që qarkullojnë në to dhe përfshin katër kategori. Në 2020 kemi rritur numrin e larjeve dhe fshirjeve gjatë periudhës verore duke e dyfishuar. Si rrjedhojë, gjatë sezonës verore mirëmbajtja e rrugëve sipas kategorive është realizuar si në vijim:

- Sheshet – larje dhe fshirje çdo ditë;
- Kategoria A – 4 larje dhe 4 fshirje në javë;
- Kategoria B – 2 larje dhe 2 fshirje në javë;
- Kategoria C – 2 larje dhe 2 fshirje në muaj;
- Kategoria D – 2 fshirje në muaj.





Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve

Mirëmbajtja dimërore organizohet përmes 9 operatorëve; 6 në zonën urbane dhe 3 në atë rurale. Përmes mirëmbajtjes dimërore të zonës urbane mirëmbahet hapësira me sipërfaqe totale 2,649,651.5m², derisa të zonës rurale mirëmbahet hapësira me sipërfaqe totale 1,535,691.0 m². Gjatë mirëmbajtjes dimërore në periudhat kur ka reshje/ngrica planifikohet hapja e rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe eliminimi i ngricave në rrugët dhe trotualet 24/7. Derisa në periudha kur temperaturat janë mbi 5°C realizohet fshirja si dhe larja e tyre. Në përgatitjet që i kemi bërë për kontratat e reja që do lidhen në 2021 e kemi ngritur numrin e rrugëve dhe zonave që do përfshihen në mirëmbajtje dimërore. Kjo është bërë për të ngritur nivelin e shërbimit për qytetarët në aspekt të mirëmbajtjes dimërore. Nga viti 2021 do kemi gjithësejt të angazhuar 11 operatorë.







Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të ndriçimit publik 2019-2020

Pas përmirësimit të motit, kemi vazhduar projektin 2019-2020 të zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit të ndriçimit publik. Lagjet/fshatrat ku janë përfunduar intervenimet gjatë 2020 përfshijnë:

- Dardani
- Kodra e Diellit
- Sofali
- Hajvali
- Velani
- Kodra e Trimave
- Vneshtat
- Taslixhe
- Ulpianë
- Përroi i Njelmët
- Vetërmnik
- Qendër



- Llukar



Me këtë projekt janë realizuar tërësisht mi 50 km ndriçim ku janë vendosur mbi 1800 drita.


Mirëmbajtja e monumenteve dhe fontanave

Monumentet, shtatorët, bustet, krojet publike dhe fontanat i përkasin hapësirave publike për të cilat DShPMSH planifikon mirëmbajtje të rregulltë si dhe rregullimin e tyre.

Të gjitha monumentet në sheshe i kemi ndriçuar për t'i dhënë më shumë dinjitet asaj që ato përfaqësojnë, kurse kemi filluar edhe me tjerat jashtë shesheve. Më konkretisht:


- Fontanës në sheshin "Ibrahim Rugova" ia kemi rregulluar pllakat dhe ndriçimin e dëmtuar si dhe e kemi ndriçuar me reflektorë shtatorën e presidentit Ibrahim Rugova.
- Fontanës kryesore në sheshin "Skenderbeu" ia kemi ndërruar pompën e dëmtuar dhe jemi duke ia rregulluar ndriçimin.
- E kemi ndriçuar me reflektorë shtatorën e Skenderbeut.
- Fontanën në sheshin "Nënë Tereza" e kemi funksionalizuar dhe ia kemi vendosur ndriçimin si dhe e kemi ndriçuar me reflektorë shtatorën e Nënë Terezës.

- Fontanat në sheshin "Zahir Pajaziti" kanë funksionuar me sistem të hapur të ujit ku vazhdimisht është shpenzuar ujë i pijshëm. Me sistemin e ri të mbyllur, nuk shfrytëzohet ujë i pijshëm por mbushen me ujë nga puset dhe i njëjti filtrohet e pastrohet rregullisht.
- Fontanave në sheshin "Edit Durham" ua rregulluam izolimin dhe ndriçimin e dëmtuar dhe u kemi vendosur pllaka të reja nga graniti natyral.
- Ia kemi vendosur ndriçimin si dhe e kemi ndriçuar me reflektorë shtatoren e Zahir Pajazitit.
- I kemi ndriçuar me reflektorë edhe monumentet tjera në sheshe.



Ngritja e vendkalimeve për këmbësorë dhe vendosja e paneleve ndriçuese te vendkalimet e këmbësorëve

Në shërbim të rritjes së sigurisë për pjesëmarrësit në komunikacion kemi përfunduar projektin për ngritjen e vendkalimeve për këmbësorë dhe ndriçimin e vendkalimeve tjera. Në tërësi, kemi vendosur 21 panela ndriçuese. Ngritja e vendkalimeve është bërë në 23 lokacione në rrugët kryesore të qytetit ku është vlerësuar se është e nevojshme rritja e sigurisë në komunikacion dhe ndikimi në zvoglimin e shpejtësisë.



Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve

Projekti për sinjalizimin është planifikuar të realizohet në afat prej 2 vitesh. Pas nënshkrimit të kontratës kemi filluar sinjalizimin horizontal dhe vertikal në pjesët urbane dhe ato rurale. Sinjalizimin e kemi realizuar në lagjet dhe fshatrat:

- Tophane
- Qendër
- Kodra e Diellit
- Arbëri
- Kodra e Trimave
- Taukbahçe
- Sofali
- Mat
- Koliq
- Rimanishtë
- Seroc
- Besi

Mirëpo, për shkak të përsëritjes së shkeljes së kontratës nga operatori ekonomik dhe mosrealizimit të porosive të ripërsëritura, organi mbikëqyrës është detyruar të kërkojë nga Departamenti i Prokurimit marrjen e masave për mos realizim të kontratës. Kontrata është shkëputur dhe, si pasojë e shkëputjes, e kemi dërguar projektin e sinjalizimit në prokurim për shpallje të re.



• Vendosja e markerave	105 copë
• Vendosja e pahive elastike	56m
• Shigjetat orientuese	5 copë
• Riparimi i shenjave	90 copë
• Furnizimi me gunga	120 m gjatësi
• Furnizimi me pengesa fizike	465.52 m. gjatësi
• Vendosja e konave kufizues	50 copë
• Furnizimi me shenja	205 copë
• Vija një komponentëshe	40875 m. gjatësi
• Vendkalime për këmbësorë (zebra)	891 m ²

Vazhdimi i kontratës 2019-2020 për furnizim dhe montim të shtyllave antiparking e rrethojave si dhe ngjyrosjen e tyre

Për krijimin e hapësirave për lëvizje të lirë në stazat dhe vendkalimet për këmbësorë dhe ruajtjen e gjelbrimit nga parkimet e parregullta është realizuar projekti për vendosjen e shtyllave antiparking, profileve metalike për mbrojtjen e hapësirave gjalbëruese dhe rrethojave. Njëkohësisht, kemi ngjyrosur një pjesë të madhe të rrethojave në varrezat e qytetit.

Përmes këtij projekti kanë vazhduar të vendosen:

- Vendosja e shtylla antiparking 695 copë
- Vendosja e profile “U” metalike 120 copë
- Vendosja e rrethojës në hapësirat publike 260m
- Ngjyrosja e shtyllave antiparking - 450 copë;
- Ngjyrosja e shtyllave U-profil -479 copë;
- Ngjyrosja e rrethojave metalike - 407 copë.
- Poashtu, është bërë lysterja e 566 metra rrethoja të varrezave.





Rrethimi i varrezave në Komunën e Prishtinës

Ndër hapësirat publike me rëndësi të veçante janë varrezat e qytetit të cilat janë në përkujdesje dhe mirëmbajtje të rregullt. Për këtë është nënshkruar kontratë e veçantë ku është ndërtuar rrethoja në gjatësi prej 315m.

Në kuadër të kësaj kontrate kanë qenë të planifikuara të rrethohen edhe varrezat e zonave rurale, mirëpo operatori ekonomik nuk ka vazhuar me punime përkundër kërkesave tona të vazhdueshme për të vazhduar me punime. Rrjedhimisht, i kemi propozuar Departamentit të Prokurimit marrjen e masave për mos realizim të kontratës.



Ofrimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Prishtinës

Komuna e Prishtinës e ka të mbuluar tërë territorin me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Ofrimi i shërbimit në zonën urbane me ndërtesa kolektive ofrohet përmes kontejnerëve publikë derisa në zonat urbane me banim individual si dhe në zonën rurale shërbimi ofrohet derë më derë. Për te dy sistemet ka të hartuar planin operativ në bashkëpunim me KRM “Pastrimi”, ku në mënyrë të rregullt bëhet grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave deri në deponinë sanitare në Mirash. Gjithashtu, për të zvogëluar numrin e deponive ilegale dhe mbajtjen e një mjedisi të pastër, DShPMSH përmes kontratës me “KRM Pastrimin” ofron edhe shërbimin e mbledhjes së mbeturinave të vëllimshme çdo 2 muaj ku gjithsej janë larguar 6,399.00 m³ mbeturina të vëllimshme.



Ndërtimi i impiantit të kompostimit

Derisa komuna ka të mbuluar tërë territorin me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, gjithashtu ka hartuar projektin për trajtimin e mbetjeve nga krasitjet dhe kositjet e hapësirave të gjelbëra. Projekti i kompostimit ka për qëllim që nga këto mbetje të krijohet kompost i cili do të përdoret me qëllim të plehërimit të hapësirave të gjelbëra. Përfitimet kryesore nga ky projekt janë:

- Zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që dërgohen në deponi;
- Zvogëlimi i kostos në transport;
- Përfitimi i kompostit për plehërim dhe kultivim të fidaneve pa kosto financiare.

Projekti ka filluar në muajin nëntor 2019 dhe është në përfundim. Komuna e Prishtinës është duke realizuar punët ndërtimore. Ndërsa, si donatorë e kemi GIZ-in gjerman me projektimin dhe trajnimin e stafit si dhe CMSR (Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim) sloven me makineri dhe pajisje. I tërë donacioni përfshin mjete dhe pajisje të një teknologjie të avancuar, me çka impianti i kompostimit në Prishtinë bëhet një model për tërë vendin.

Deri më tani janë pranuar makineritë dhe pajisjet nga CMSR dhe jemi në përfundim të punëve ndërtimore.





Ndërtimi i mureve rezistuese

Për të siguruar hapësirat publike nga rrëshqitjet apo shembjet eventuale në vendet ku paraqitet rrezik për qytetarët apo pronën e tyre, është realizuar projekti i ndërtimit të mureve rezistuese.

Me këtë projekt është intervenuar në 4 lokacione:

- Rruga “Carraleva”, 14.3m gjatësi
- Rruga “Avdyl Rama”, 13.3m gjatësi
- Rruga “Ismet Asllani”, 6.3m gjatësi
- Rruga “Trepça”, 61.5m gjatësi

Përmes këtyre mureve janë siguruar rruga, trotuari dhe prona private ngjitur më hapësirën publike.





Riorganizimi i lokacioneve të kontejnerëve

Projekti i riorganizimit të lokacionit të kontejnerëve ka filluar në vitin 2019. Riorganizimi i lokacioneve të kontejnerëve është përcaktuar nga grupi punues me pjesëmarrës nga Komuna e Prishtinës, KRM Pastrimi dhe GIZ për lagjet:

- Tophane
- Lakërishte
- Qafa
- Parku i Qytetit
- Pejton
- Qendër
- Muhaxherët

Pas përcaktimit të lokacioneve nga grupi punues, e kemi tenderuar ndërtimin e platformave për lokacionet përkatëse dhe kontrata është nënshkruar në tremujorin e fundit të 2020. Deri në fund të 2020 janë realizuar platformat në 19 nga 56 lokacionet e parapara.





Pastrimi i shtretërve të lumenjëve, kolektorëve atmosferikë, kanaleve të hapur dhe përrockave si dhe vendosjen e kapakëve të ujëmbledhësve

Komuna e Prishtinës ka pozitë gjeografike me teren të përthyer, që krijon kushte për vërshime gjatë kohës me reshje. Prandaj, që nga viti 2019 planifikohet projekti për pastrimin e shtretërve të lumenjëve, përrockave, kanaleve të hapur dhe rrjetin e kanalizimit atmosferik, me qëllim të parandalimit të vërshimeve apo të zvogëlimit të dëmeve nga vërshimet eventuale. Këto intervenime bëhen 2 herë në vit; në sezonën pranverë-verë dhe vjeshtë-dimër dhe përfshijnë:

- Pastrimin dhe largimin e mbeturinave nga shtrati i lumenjëve – mbi 25 km gjatësi
- Pastrimin e përrockave – mbi 27 km gjatësi
- Pastrimin dhe deblokimin e kolektorëve atmosferikë – mbi 108 km gjatësi
- Pastrimi i portave hyrëse rurale: 38 Copë
- Pastrimi i portave hyrëse urbane: 4 Copë
- Pastrimi i kolektorit atmosferik: 180,3 km
- Pastrimi i përrockave rurale: 15.6km
- Pastrimi i përrockave urbane: 10.14km



Me këtë projekt kemi paraparë edhe vendosjen e ujëmbledhësve nga materiali kompozit si masë parandaluese për vjedhjen e tyre. Gjithësejt kemi vendosur:

- 17m gjatësi ujëmbledhës atmosferikë në profil tërthor të rrugëve
- Furnizimi me kapakë të ujëmbledhësve 9 copë
- Furnizimi me kapakë të grilave tërthore 19 copë
- Furnizimi me kapakë nga beton arma 16 copë
- Furnizimi me kapakë grila kompozit 45 copë



Renovimi dhe rregullimi i ashensorëve

Projekti për renovimin, rregullimin dhe ndërtimin e ashensorëve në objektet kolektive në ndërtesat e vjetra shumëkatëshe ka ndikuar shumë në lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve, në veçanti të personave me nevoja të veçanta, të moshuarve dhe nënave me karroca me fëmijë të vegjël.

Gjatë vitit 2020 kemi ndërtuar 3 ashensorë të rinjë dhe kemi renovuar dhe rregulluar 7 ashensorë ekzistues. Me këtë projekt kemi lehtësuar në mënyrë domethënëse lëvizjen e banorëve në 10 ndërtesa kolektive duke rregulluar, rinovuar dhe ndërtuar 10 ashensorë në lagjet:

- Kodra e Diellit
- Ulpianë
- Qafa
- Lakrishtë
- Dardani



Furnizimi dhe montimi i pompave për furnizim me ujë të pijshëm në ndërtesa kolektive

Në disa pjesë të qytetit në objektet e vjetra të banimit kolektiv, për shkak të lartësisë, sistemi i ujësjetillësit nuk ka shtypje të mjaftueshme dhe si pasojë katet e larta nuk kanë furnizim të mjaftueshëm me ujë të pijshëm. Prandaj kemi montuar pompat shtytëse në disa objekte me probleme të theksuara me qëllim që banorët e të gjitha kateve të kenë furnizim me ujë të pijshëm.

Kemi montuar pompat e ujit në banesat e rasteve sociale, invalidëve e veteranëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve në Hajvali dhe në banesa kolektive në Ulpianë. Gjithësejt janë vendosur 11 sosh.



Trajtimi i qenëve endacak

Komuna e Prishtinës ka nënshkruar kontratën për ndërtimin e strehimores për trajtimin e qenve endacakë që pritet të fillojë së shpejti. Me ndërtimin e strehimores planifikohet të rriten kapacitetet e trajtimit të qenve endacakë, ngase Prishtina ballafaqohet me numër të madh të tyre që shkaktojnë probleme tek qytetarët duke i sulmuar dhe shqetësuar.

Duke parë që numri i qenve endacakë në Komunën e Prishtinës është shumë i madh dhe po ashtu kërkesat për intervenim nga qytetarët janë të mëdha, deri në ndërtimin e strehimores, kemi vazhduar me trajtimin e qenve endacakë përmes operatorëve ekonomikë.

Gjithësejt në 2020 deri më tani janë trajtuar mbi 1000 qenë.

Poashtu, në kuadër të përmirësimit të situatës kemi vendosur 5 pika ushqyese. Këto pika furnizohen çdo ditë me ushqim për qentë endacakë me nga 5 kg ushqim për secilën pikë. Ky projekt është mirëpritur dhe ka pasur ndikim pozitiv sidomos gjatë sezonit dimëror dhe pandemisë, ngase largimi i urisë ka ndikuar sadopak në uljen e agresivitetit të këtyre qenve.



Mbështetja për zjarrfikësit

Me qëllim të rritjes së efikasitetit, lehtësimit të punës dhe ngritjen profesionale për Brigadën Profesionale të Zjarrfikësve në Prishtinë, në vazhdimësi kemi ofruar mbështetjen tonë brenda mundësive ligjore dhe financiare. Në 2020 zjarrfikësit i kemi pajisur me:



- Automjetin komandues me pajisjet përcjellëse që do të ndihmojë në lehtësimin dhe koordinimin e ekipeve reaguese të BPZ-së. Reagimi dhe përgjigja me kohë në raste të fatkeqësive shpeshherë është jetike.
- Pompat thithëse, 4 copë, për largimin e ujit në rast të reshjeve dhe vërshimeve në podrumet e ndërtesave kolektive dhe gjetiu. BPZ dhe DShPMSH do të jenë në gjendje t'u dalin në ndihmë më shpejt qytetarëve. Dy pompa punojnë me lëndë djegëse me kapacitet 456l/m dhe dy pompa punojnë me energji elektrike me kapacitet 1000l/m.
- Pajisjet për intervenime teknike si motorr sharra speciale për prerje të betonit, motorr sharre speciale për prerje të llamarinës dhe pajisje për thyerje të shtresave të betonit.



Rrethrotullimi turbo

Në kuadër të bashkëpunimit me Komunën e Shkupit dhe takimeve që kemi pasur lidhur me rregullimin e qarkullimit të rrjedhshëm të trafikut në rrethrotullime, kemi shkëmbyer përvojat për projektimin e rrethrotullimit të parë “Turbo” në Prishtinë. Ky lloj i rrethrotullimit shërben për mënjanimin e pikave të kontaktit brenda tij si dhe kyçja në dhe çkyqja nga rrethrotullimi të bëhet më e lehtë në mënyrë që mos të ketë ngulfatje brenda tij për shkak të numrit të madh të pikave të kontaktit.

Profesori Jovan Hristoski nga Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, i cili ka qenë i përfshirë në rregullimin e rrethrotullimeve “Turbo” në Komunën e Shkupit, na përgatiti si dhuratë projektin për rrethrotullim e parë “Turbo” në Prishtinë, të cilin synojmë të realizojmë te rrethi i Flamurit pasi që është ndër më të ngarkuarit me komunikacion. Projektin e kemi zhvilluar tutje duke synuar ta avansojmë dhe t’i ofrojmë Prishtinës diçka çka nuk e ka pasur deri tani. Përveç aspektit funksional ku do të kontribuojë projekti i dërguar nga profesor Hristoski, është bërë shumë punë nga ekipet e komunës sonë për t’i ofruar qytetit një projekt të shkëlqyeshëm edhe në aspekt estetik. Janë paraparë gurë të ndryshëm dekorativ për secilin ishull të vogël që do krijohet në këtë rrethrotullim, është përcaktuar edhe një hapësirë ku do vendoset një statujë e Hynjeshës në Fron, simbolit të Prishtinës, si dhe janë paraparë intervenime me beton të stampuar dhe intervenime tjera me qëllim që t’i japim Prishtinës një pamje që e meriton.






Kamerat e sigurisë

Sheshet e qytetit të Prishtinës janë të frekuentuara shumë nga qytetarët dhe janë vende ku organizohen shumë aktivitete, prandaj është shumë e nevojshme që edhe siguria të jetë në nivel sa më të lartë.

Për këtë kemi realizuar projektin për furnizimin, montimin dhe funksionalizimin e sistemit të kamerave në sheshe, nga hoteli “Grand” deri të sheshi “Adem Jashari”. Monitorimi është i vendosur në Qendrën e Thirrjeve të Komunës e cila është aktive 24/7.

Ky sistem do të ndihmojë edhe organet e rendit që të identifikojnë rastet nga keqbërësit e ndryshëm. Deri tani kemi pasur një kërkesë nga Policia e Kosovës për identifikimin e vjedhësit të një bicikle të shesh të cilin zyrtarët e përkatës të DShPMSH kanë arritur ta identifikojnë pas analizimit të inçizimeve nga këto kamera. Dëmtimet e shumta që i kemi pasur në fontana, monumente, ndriçim publik dhe mobileri tjera urbane besojmë se tash e tutje do zvogëlohen përmes identifikimit të atyre që i shkaktojnë këto dëmtime.



Rifillimi i vendosjes së mobilerisë urbane

Me rifillimin e punës nga operatori ekonomik për furnizimin dhe montimin e mobilerisë urbane në qytetin e Prishtinës ka filluar vendosja e shportave për mbeturina të xhepit dhe ulëseve. Në këtë kontratë kemi planifikuar edhe shtylla antiparking dhe rrethoja për hapësira publike.




Pritoret

Në kuadër të kompletimit të Planit të Mobilitetit dhe kompletimit të infrastrukturës së transportit publik të udhëtarëve, jemi në proces të realizimit të projektit për vendosjen e pritoreve në vendndaljet për autobusët e transportit publik në linjat urbane. Deri më tani kemi vendosur 50 pritore në rrugët kryesore të qytetit.



Intervenime emergjente

Shumë herë kemi intervenime emergjente në rastet kur kemi reshje të intenzitetit të lartë, erëra të forta, shembje dheu, dëmtime të çatave, drunjë të rrëzuar e ngjarje të tjera që rrezikojnë jetën dhe pronën e qytetarëve. Në këto raste aktivizohen ekipet emergjente me kapacitetet dhe mjetet përkatëse për ta parandaluar apo zvogëluar rrezikun. Sipas nevojës, veprimet janë të koordinuara edhe me akterë tjerë si zjarrfikësit dhe policinë. Për këtë arsye dhe jemi munduar që edhe BPZ-në ta pajisim me mjete të nevojshme me të cilat mund t'u dalin në ndihmë qytetarëve. Gjatë vitit 2020 janë trajtuar 145 raste nga inspektorët e mbrojtjes dhe shpëtimit.



Mirëmbajtja e semaforëve

DShPMSH bënë mirëmbajtjen e rregullt të semaforëve në Prishtinë. Në rast të dëmtimit nga aksidentet apo të ngjashme ndërhyrja bëhet menjëherë. Me kontratën që kemi përgatitur shërbimi nga operatori ekonomik është paraparë të ofrohet edhe fundjavave, festave etj.



Mirëmbajtja e ndriçimit publik

Mirëmbajtja e ndriçimit publik e cila ka qenë në realizim për 3 vite 2017/2020 ka përdunuar në 2020. Me muaj të tërë kemi qenë në procedura të prokurimit për kontratën e mirëmbajtjes së ndriçimit. Ankesa të përsëritura, anulim i tenderit, ritenderim, përsëri ankesa në OSHP.

Duke marrë parasysh gjendjen e rënduar në qytet, është bërë kërkesë për kontratë emergjente.

Me datën 08.02.2021 kanë përfunduar procedurat dhe është lidhur kontrata ku menjëherë është filluar me rregullimet e nevojshme të ndriçimit publik. Për pak ditë e kemi rifunksionalizuar ndriçimin në shumë rrugë. Jemi duke punuar me kapacitete maksimale dhe për pak kohë do ta normalizojmë gjendjen në tërë rrjetin e ndriçimit publik.





Rastet e pranuarë në Qendrën e Thirrjeve

Në kuadër të Sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim e kemi Qendrën e Thirrjeve e cila funksionon 24/7. Tabela e mëposhtme paraqet thirrjet e pranuarë nga qytetarët për secilin muaj të 2020. Në këtë qendër qytetarët raportojnë raste që u përkasin të gjitha drejtorive dhe njësisve tjera komunale.

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Rastet	455	425	427	333	499	516	471	591	474	422	348	404
Gjithsej:	5365 raste											

Të hyrat

DShPMSH arkëton të hyra nga tregu i automjeteve, laura në parkun “Gërmia”, taksa për shfrytëzimin e hapësirave publike, konfiskimi i veturave, parkingu te Pallati i Rinisë, taksa për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Tabela e mëposhtme prezanton të hyrat për 2019 dhe 2020.

	Te hyrat 2019	Te hyrat 2020
Të hyra nga pag. e mbeturinave	2,077,095.52€	1,958,223.76 €
“Hortikultura”, “Gërmia”. “T. Aut.”	308,051.00€	164,989.50 €
Konfiskim i automjeteve	78,793.00€	65,498.25 €
Parkingu te “Pallati i Rinisë”	87,953.45€	6,765.65 €
Taksë për shf. e hapësir. publike	306,069.27€	35,715.12 €
Gjithsej	2,857,962.24€	2,231,192.28 €

Niveli i të hyrave në krahasim me vitin 2019 ka pësuar ulje duke u bazuar në indikatorët si në vijim:

- Për arsye të pandemisë pagesat për mbeturina por edhe tjerat brenda secilit institucion kanë pasur rënie;
- Për shfrytëzimin e hapësirave publike lokalet afariste janë liruar me vendim të Asamblesë Komunale pasi që nuk kanë pasur mundësi t’i shfrytëzojnë ato gjatë shumicës së vitit 2020 si pasojë e pandemisë;

- Për shkak të kufizimeve të lëvizjes në hapësira publike dhe parqe ka pasur reduktime në hyrje të Parkut të Gërmisë dhe rrjedhimisht ulje në të hyra;
- Tregu i automjeteve përgjatë pandemisë nuk ka punuar. Si pasojë edhe këtu kemi ulje në të hyra.

Planifikimi i punëve (aktiviteteve) – punët ose aktivitetet të cilat do të fillojnë, janë duke vazhduar, dhe ato të cilat janë të planifikuara dhe ende nuk janë përfunduar.

Aktivitetet (punët) që janë duke vazhduar nga viti 2020:

1. Pastrimi i shtratit të lumenjve, portave hyrëse në kolektor, kanalit atmosferik dhe zëvendësimi i kapakëve të pusëve;
2. Mirëmbajtja e ndriçimit publik;
3. Rregullimi i nënkalimeve;
4. Riparimi dhe rregullimi i ashensorëve;
5. Menaxhimi i mbeturinave me sistemin e ri, ku arkëtimi kryhet në Komunë, kurse punët operative i kryen KRM “Pastrimi”;
6. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, zhbllokimi i kanalizimit atmosferik;
7. Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve, zhbllokimi i kanalizimit atmosferik;
8. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve rurale;
9. Mirëmbajtja e monamenteve, fontanave dhe krojeve;
10. Ndërtimi i impiantit të kompostimit;
11. Furnizimi dhe montimi i mobilieria urbane;
12. Furnizimi dhe montimi i pritoreve për autobusë;
13. Mirëmbajtja e semaforëve;
14. Riorganizimi i lokacionit të kontejnerëve; rregullimi i vendit dhe furnizimi me kontejnerë;
15. Pasurimi i databazës për konsumatorët e shërbimit të mbledhjes së mbeturinave përmes inkuorporimit të regjistrimeve të reja në Protaks;
16. Regjistrimi i objekteve të vjetruara dhe zonave me rrezikshmëri të lartë;
17. Përpunimi i planeve emergjente POE, PMZ, PRRFN;
18. Mbledhja e të dhënave dhe punimi i raportit dhe raportimi në AMMK për vitin 2020;
19. Ndërtimi i strehimores për qentë endacakë 2020/2021;
20. Trajtimi i qeneve endacak;
21. Pranimi dhe punimi i lëndëve nga Komisioni i ankesave për mbeturina dhe ekzekutimi i vendimeve në bazën e të dhënave;
22. Menaxhimi i parkingut për automjetet e konfiskuara;
23. Menaxhimi i kontratës së shërbimit për rimorkim “marimangë”;
24. Rishikimi dhe inkuorporimi i ndryshimeve të nevojshme në bazën e të dhënave për konsumatorët e shërbimit për grumbullim të mbeturinave;
25. Pranimi dhe delegimi i ankesave përmes qendrës së thirrjeve;
26. Pranimi i ankesave nga Platforma digjitale dhe Ndreqe.com, dhe adresimi i tyre;
27. Rregullimi i trafikut në rrethrotullime, ndarja fizike e shiritit rrugor në rreth rotullime dhe vendosja e tabelave informuese në portale dhe gjysmë portale

Aktivitete (punët) që do të fillojnë në vitin 2021.

1. Konsulencë për identifikimin e nevojave për komunikacion dhe trafik rrugor dhe trajtimin e hapësirave publike;
2. Inventarizimi i hapësirave publike;
3. Fushata vetëdijesuese (hedhja e mbeturinave, kyçja dhe shkyçja në rreth rotullim, parkimi në hapësirat e caktuara për parkim, shfrytëzim eficient i energjisë etj.);
4. Riorganizimi i kontejnerëve 2021/2022;

5. Intervenime, riparime dhe mirëmbajtja urgjente: intervenime me pompa shtytëse të ujit, puseta dhe ujëmbledhës, kanalizim atmosferik, fontana, kroje publike, monumente dhe mure rezistuese;
6. Mirëmbajtja e monumenteve, fontanave dhe krojeve publike 2021/2022
7. Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik 2021;
8. Vendosja rregullimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve 2021/2022;
9. Mirëmbajtja e rrugëve rurale;
10. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal
11. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, zhbllokimi i kanalizimit atmosferik;
12. Punimi i rrethojave për varreza dhe hapësira tjera publike
13. Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve, zhbllokimi i kanalizimit atmosferik;
14. Ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve, montimi i paneleve ndriçues në vendkalime dhe matësve të shpejtësisë
15. Trajtimi i qenëve endacakë
16. Hartimi i rregullores së brendshme të DSHPMSh-së;
17. Mirëmbajtja e semaforëve 2021/2024;
18. Trajtimi i mbeturinave ndërtimore;
19. Mbledhja e të dhënave dhe punimi i raportit dhe raportimi në AMMK për vitin 2020;
20. Krijimi i sistemit për monitorimin e aktiviteteve financiare të DSHPMSh-së;
21. Përgatitja e projektregulloreve dhe procedimi për miratim: Rregullorja për organizimin e transportit rrugor, Rregullorja për obligimet e pronarëve dhe bashkëpronarëve të pronës në Komunën e Prishtinës, Rregullorja për mbrojtjen e mjedisit.
22. Përgatitja e projektbuxhetit të DSHPMSh-së për 2022;
23. Përgatitja e Planit të prokurimit të DSHPMSh-së 2022;
24. Rishikimi 3-mujor i Planit të punës.

Përmbledhje – Progresi i drejtorisë drejt realizimit të objektivave të vendosura për vitin 2020 (këtu mund të përfshihen edhe monitorimet nga organizatat joqeveritare).

Raporti i performancës

Raporti i performancës së komunave i realizuar nga MAPL për vitin 2019 ka vlerësuar secilën komunë në bazë të disa kritereve. Treguesit e fushave që mbulohen nga DShPMSh e Komunës së Prishtinës janë vlerësuar si në vijim:

- **Hapësira Publike: 100%**
Përpos nivelit të hapësirave të gjelbra për kokë banori, kjo fushë matë edhe sipërfaqen e hapësirave publike të cilat mirëmbahen rregullisht nga komuna, si dhe numrin e hapësirave publike të përcjella me ndriçim publik.
- **Menaxhimi i fatkeqësive: 81.88%**
Përmes këtij treguesi prezantohen intervenimet e institucioneve komunale ndaj fatkeqësive.
- **Transporti publik: 78.5%**
Përmes këtij treguesi prezantohen vendndalimet e shenjëzuara, vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik dhe realizimi i planit komunal për transport lokal publik.
- **Menaxhimi i mbeturinave: 73.86%**
Përmes këtij treguesi prezantohen sasia e mbeturinave që deponohet, niveli i inkasimit, realizimi i orarit për mbledhje dhe numri i ekonomive familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave. Në të gjitha pikat tjera Komuna e Prishtinës arrin 100% përveç të asaj të realizimit të inkasimit ku ende kemi ngecje.
- **Parkingjet Publike: 57.2%**
Përmes këtij treguesi prezantohen numri i vendparkingjeve për persona me aftësi të kufizuara, vendparkimet e destinuar për taksit dhe vendparkimet për mjete motorike.

Nr.	Emërtimi i kontratës	Nr. i prokurimit	Viti Kontraktues	Vlera kontratës	Te paguara në vitin 2020	Komentet
1	Vendosja, Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve	616 20 068 521	2020-2021	155,345.00 €	0.00 €	Kontratë e lidhur në dhjetor 2020
2	Ndërtimi i strehimores për qentë endacak dhe trajtimi i tyre	616 20 142 521	2020-2021	108,587.40 €	0.00 €	Kontratë e lidhur në dhjetor 2020
3	Mirëmbajtja e semaforëve	616 20 088 221	2020-2021	50,000.00 €	0.00 €	Në realizim
4	Mobileria urbane-Furnizimi dhe vendosja e pritoreve për autobus të transportit publik të udhëtarëve	616 19 132 111	2019-2021	292,500.00 €	0.00 €	Në realizim
5	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale Lloti I	616 19 179 211	2020-2021	67,621.70 €	24,910.00 €	Në realizim
6	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale Lloti II	616 19 179 211	2020-2021	82,754.59 €	19,848.66 €	Në realizim
7	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale Lloti III	616 19 179 211	2020-2021	62,943.91 €	15,594.00 €	Në realizim
8	Mirëmbajtja e hapësirave publike të rrugëve dhe trotuarëve në viset rurale -Lloti I	616 20 106 521	2020-2021	40,000.00 €	2,763.01 €	Në realizim
9	Mirëmbajtja e hapësirave publike të rrugëve dhe trotuarëve në viset rurale -Lloti II	616 20 106 521	2020-2021	100,000.00 €	18,131.00 €	Në realizim
10	Mirëmbajtja e hapësirave publike të rrugëve dhe trotuarëve në viset rurale -Lloti III	616 20 106 521	2020-2021	100,000.00 €	26,848.47 €	Në realizim

11	Intervenimi dhe mirëmbajtja në pompa, kanalizimi atmosferik, fontanna, kroje publike, monumente dhe mure rezistuese - Loto I	616 20 060 521	2020-2021	84,249.20 €	67,631.70 €	Në realizim
12	Intervenimi dhe mirëmbajtja në pompa, kanalizimi atmosferik, fontanna, kroje publike, monumente dhe mure rezistuese - Loto II	616 20 060 521	2020-2021	25,000.00 €	14,564.00 €	Në realizim
13	Intervenimi dhe mirëmbajtja në pompa, kanalizimi atmosferik, fontanna, kroje publike, monumente dhe mure rezistuese - Loto III	616 20 060 521	2020-2021	75,000.00 €	6,780.00 €	E shkëputur për shkak të tërheqjes nga OE
14	Trajtimi i qenëve endacak	616 20 140 221	2020-2021	40,000.00 €	14,157.00 €	Në realizim
15	Trajtimi i qenëve endacak	616 20 066 225	2020	20,000.00 €	20,000.00 €	E përfunduar
16	Mobileria urbane- rregullimi i ulëseve dhe elementeve tjera për siguri të këmbësorëve në hapësira publike	616 19 5770 521	2019-2021	249,650.00 €	0.00 €	Në realizim
17	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuarëve të qytetit, deblokimi i kanalizimit atmosferik-Loto 1	616 18 025 211	2019-2022	261,722.50 €	153,422.23 €	Në realizim
18	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuarëve të qytetit, deblokimi i kanalizimit atmosferik-Loto 2	616 18 025 211	2019-2022	245,418.44 €	151,310.70 €	Në realizim

19	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuarëve të qytetit, deblokimi i kanalizimit atmosferik-Loto 3	616 18 025 211	2019-2022	409,969.38 €	190,878.73 €	Në realizim
20	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuarëve të qytetit, deblokimi i kanalizimit atmosferik-Loto 4	616 18 025 211	2019-2022	194,391.28 €	129,244.18 €	Në realizim
21	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuarëve të qytetit, deblokimi i kanalizimit atmosferik-Loto 5	616 18 025 211	2019-2022	213,680.72 €	155,194.18 €	Në realizim
22	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuarëve të qytetit, deblokimi i kanalizimit atmosferik-Loto 6	616 18 025 211	2019-2022	257,543.06 €	144,868.23 €	Në realizim
23	Ndërtimi i impiantit të kompostimit	616 19 129 521	2019-2020	139,782.20 €	85,791.77 €	Vonesat janë paraqitur si pasojë e rritjes së vlerës investive nga donatori CMSR e cila ka rezultuar në nevojën për punë shtesë
24	Ndërtimi i impiantit të kompostimit-punë shtesë-aneks kontratë	616 19 129 521	2019-2020	13,900.00 €	0.00 €	

25	Riorganizimi i kontejnerëve, kontejner të rinjë, rregullimi i platformave furnizimi me komposter dhe shporta	616 20 085 521	2020-2021	82,795.06 €	26,290.31 €	Në realizim
26	Ndërtimi i mureve rezistuese ndaj rreshqitjës së dheut, vershimeve etj.	616 19 048 521	2019-2020	50,000.00 €	25,065.58 €	E përfunduar
27	Shpimi i puseve dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes për gjelbërim	616 19 049 521	2019-2020	150,000.00 €	10,614.65 €	E përfunduar
28	Ndërtimi i vendkalimeve për këmbësorë-kabinave të autobusëve dhe rregullimi	616 19 133 521	2019-2020	134,100.00 €	120,933.00 €	E përfunduar
29	Shtyllat antipark dhe shtyllat lëvizëse	616 18 050 121	2019-2020	41,500.00 €	25,747.80 €	E përfunduar
30	Rregullimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve	616 19 046 521	2019-2020	200,000.00 €	191,566.00 €	E përfunduar
31	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve	616 19 146 511	2019-2020	593,650.00 €	34,180.78 €	Për shkak të papërgjegjësisë së OE dhe vonesave në realizim të kontratës është dërguar për shkëputje.
32	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik	616 19 067 521	2019-2020	300,000.00 €	62,685.77 €	E përfunduar
33	Vendosja e kamerave të sigurisë në qytet	616 19 059 521	2019-2020	78,299.00 €	78,299.00 €	E përfunduar
34	Rregullimi dhe montimi i pompave për furnizim me ujë në ndërtesa kolektive	616 19 047 521	2019-2020	70,000.00 €	68,351.00 €	E përfunduar

35	Pastrimi i shtratit ë lumenjëve dhe i kanalizimeve atmosferike nga pusetë në pusetë	616 19 119 521	2019-2020	95,183.40 €	61,064.40 €	E përfunduar
36	Rregullimi dhe rrethojat e varrezave	616 19 059 521	2019-2020	100,000.00 €	9,711.00 €	Për shkak të papërgjegjësisë së OE dhe vonesave në realizim të kontratës është dërguar për shkëputje.
37	Blerja e paisjeve për zjarrëfikësa	616 20 2483 121	2020	19,840.00 €	19,840.00 €	E përfunduar
38	Mirëmbajtja, furnizimi dhe rregullimi i 16 pikave të sistemit të alarmimit publik	616 18 516 221	2018-2021	29,900.00 €	9,960.00 €	Kontratë në realizim për 3 vite
39	Trajtimi i mbeturinave ndërtimore	14-024/01-316058/13	2020	150,000.00 €	150,000.00 €	E përfunduar
40	Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit -PJESA 1	616 18 015 211	2018-2021	89,168.03 €	89,161.68 €	E përfunduar
41	Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit -PJESA 2	616 18 015 211	2018-2021	88,921.61 €	88,633.70 €	E përfunduar
42	Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit -PJESA 3	616 18 015 211	2018-2021	179,752.04 €	134,585.73 €	E përfunduar
43	Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit -PJESA 4	616 18 015 211	2018-2021	120,768.96 €	120,259.64 €	E përfunduar
44	Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit -PJESA 5	616 18 015 211	2018-2021	105,085.77 €	105,061.31 €	E përfunduar
45	Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve të qytetit -PJESA 6	616 18 015 211	2018-2021	142,810.20 €	141,511.25 €	E përfunduar
46	Riparimi, larja, pastrimi i fontanave, krojeve dhe monumenteve Lloto I-II	616 17 62 521	2017-2020	25,000.00 €	5,827.00 €	E përfunduar

47	Mirëmbajtja dhe rikonstruimi i rrjetit të ndriçimit publik – LLOT I	616 17 008 521	2017-2020	23,782.30 €	2,193.90 €	E përfunduar
48	Mirëmbajtja dhe rikonstruimi i rrjetit të ndriçimit publik – LLOT II	616 17 008 521	2017-2020	19,872.90 €	2,173.30 €	E përfunduar
49	Mirëmbajtja dhe rikonstruimi i rrjetit të ndriçimit publik – LLOT III	616 17 008 521	2017-2020	10,329.00 €	1,204.40 €	E përfunduar
50	Ofrimi i shërbimeve primare të menaxhimit dhe grumbullimit të mbeturinave në gjithë teritorine Komunës së Prishtinës	14-024/01-316059/19	2020	3,117,948.00 €	2,969,534.00 €	E përfunduar
51	Shërbimet e transportit publik në Komunën e Prishtinës	616 18 84 215	2020	3,689,674.82 €	3,689,674.82 €	E përfunduar
52	Mirëmbajtja e semaforëve, invertorëve dhe pajimeve akustike për të verbërit në qytetin e Prishtinës	616 17 111 211	2017-2020	149,960.00 €	36,126.00 €	E përfunduar
53	Zhvendosja dhe montimi I shtyllave të ndriçimit publik në lagjën Dardania	616 20 075 525	2020	10,000.00€	10,000.00€	E përfunduar
54	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik-punë shtesë	616 20 011 525	2020	29,998.20€	29,996.00€	E përfunduar
TOTALI I REALIZUAR GJATË VITIT 2020:					9,562,189.88 €	